

REVISTA JURIDIKE SHQIPTARE

EFEKTIVITETI I APLIKIMIT TË VEPRAVE
PENALE TË ABUZIMIT ME BUXHETIN E
SHTETIT NË RAPORT ME DËMIN QË
SHKAKTOHET

Arbesa Kurti

PUBLIKUES

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)
Rr. Milto Tutulani, Nd.1, Ap. 3. (Dora D'Istria)
Tel: +355 44 104 247
E-mail: info@em-al.org
Web: www.em-al.org

AUTORË

Arbesa Kurti

VITI I PUBLIKIMIT

tetor 2024

Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e Lëvizjes Europiane në Shqipëri, Revistës Juridike Shqiptare dhe autorëve.



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Hyrje	03
Dinamikat e ndryshimit të veprave penale për mbrojtjen e buxhetit të shtetit	04
Raporti midis dëmit në buxhetin e shtetit dhe ngarkimit me përgjegjësi penale	05
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	08
REFERENCA	09
ANNEX I - PËRKUFZIME	
ANNEX II - DISA NGA VEPRAT PENALE ME OBJEKT MBROJTJEN E BUXHETIT/ FONDEVE PUBLIKE	

Mirëfunksionimi i shtetit të së drejtës kërkon që paratë publike të përdoren për të mirën e interesit publik, për zhvillimin ekonomik, social, politik, kulturor të vendit. Ndërmarrja e nismave ligjore ndër vite për rregullimin e funksionimit të aparatit shtetëror, ka pasur në fokus edhe mënyrën e mirëmenaxhimit të buxhetit shtetëror nga organet e qeverisjes qendrore dhe vendore.

Për të minimizuar dhe parandaluar shpërdorimin e parave publike dhe menaxhimin në përputhje me ligjin e taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera buxhetore janë parashikuar masa ndëshkuese administrative dhe penale.

Ngarkimi me përgjegjësi administrative dhe/ose penale të subjekteve që kryejnë veprime apo mosveprime të kundraligjshme në menaxhimin e buxhetit, ka nxitur nevojën për ndryshimin e vazhdueshëm të normave ligjore, duke i përshtatur me ndryshimet teknologjike, sociale, ekonomike, politike etj.

Në Kodin Penal janë parashikuar disa vepra penale që kanë si objekt mbrojtjen e buxhetit të shtetit, rregullimin e funksionimit të aparatit shtetëror, duke pasur si qëllim vendosjen përpara përgjegjësisë të çdo funksionari, i cili me veprime apo mosveprime ndikon në keq menaxhimin dhe shpërdorimin e parave publike.

Ndonëse raportet zyrtare të organeve audituese, si dhe raportet ndërkombëtare kanë faktuar që buxhetit të shtetit i shkaktohen dëme të konsiderueshme, për shkak të veprimeve dhe mosveprimeve të funksionarëve publikë, numri i personave që ngarkohen me përgjegjësi është i

vogël dhe riparimi i dëmit është gati i papërfillshëm. Shumë nga veprat penale të cilat janë në fuqi dhe kanë për qëllim mbrojtjen e fondeve publike që gjenerohen nga taksat, subvencionet, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, prokurimet/tenderat publikë janë shumë pak të vëna në zbatim, ose në pjesën më të madhe ligjzbatuesit i kualifikojnë veprimet dhe mosveprimet drejt veprës penale që ka ndëshkimin më të vogël, si psh. shpërdorimi i detyrës. Një element tjetër që vihet në dukje është mos përdorimi i mjeteve juridike për riparimin e dëmit që vjen nga keqpërdorimi i fondeve publike.

A është e domosdoshme që të rishikohen dhe të ridimensionohen veprat penale për mbrojtjen e fondeve publike, duke i kanalizuar drejt një qëllimi të vetëm, duke shmangur në këtë mënyrë mbivendosjen e tyre dhe diskrecionin për të zbatuar dispozitat që janë më të favorshme dhe kanë dënim më të ulët për funksionarët publikë? A duhet të vihen në zbatim dispozitat për riparimin e dëmit të shkaktohet në buxhet nga funksionarët publikë? Në këtë dokument të shkurtër, synohet të paraqitet një panoramë e veprave penale që mbrojnë paratë publike në raport me dëmin që shkaktohet, problematikat që konstatohen dhe rekomandimet për përmirësimin e situatës dhe mbrojtjen e fondeve publike. Nëpërmjet këtij dokumenti jemi të vetëdijsëm që nuk mund të analizojmë të gjitha aspektet dhe dinamikën e politikës penale dhe parandalimin e dëmeve që i shkaktohen buxhetit të shtetit, por mund të përbëjë një indicie për studime me të thelluara dhe ndërmarrjen e veprimeve konkrete për përmirësimin e situatës.

Dinamikat e ndryshimit të veprave penale për mbrojtjen e buxhetit të shtetit

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë është miratuar në vitin 1995. Nga kjo kohë është ndryshuar rreth 20 herë. Me qëllim përshtatjen me ndryshimet sociale, ekonomike, politike etj. shumë nga veprat penale janë depenalizuar ose inkriminuar. Ndryshime ka pasur dhe në fushën e veprave penale që kanë për objekt mbrojtjen dhe garantimin e mirëfunksionimit të aparatit shtetëror.

Mbrojtja e buxhetit të shtetit nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme të funksionarëve publikë, të cilët kanë shkelur ligjin dhe kanë shpërdorur paratë publike duke sjellë dëm ekonomik, i cili përkthehet dhe në më pak shërbime dhe të mira për qytetarët, parashikohen në shtatë vepra penale të Kodit Penal,[1] të tilla si: “Mashtrimi në subvencione”, “Shpërdorimi i kontributeve të dhëna nga shteti”, “Moskryerja e detyrave nga organet tatimore”, “shpërdorimi i detyrës”, “Korrupsioni” etj.

Veprat penale të sipërcituar janë ndryshuar të paktën një herë, ndërsa vepra penale e shpërdorimit të detyrës është ndryshuar 4 herë, ndryshime që lidhen me mënyrën e kryerjes nga ana objektive të veprës penale, masës dhe llojit të dënimit.

Shpesh veprat penale, të cilat kanë për objekt funksionimin në përputhje me ligjin të administratës publike dhe mbrojtjen e buxhetit të shtetit/fondeve publike konkurrojnë midis

tyre, duke krijuar një mbivendosje, se për cilën vepër penale do të ngarkohet me përgjegjësi penale personi që ka kryer një veprim apo veprim që ka dëmtuar interesat ekonomike të shtetit.

Nëse i krahasojmë veprat penale konstatojmë që ato kanë të njëjtin objekt, ana objektive e kryerjes së veprës penale është e njëjtë, këto vepra konsumohen nëpërmjet kryerjes së veprimeve dhe mosveprimeve që vijnë në kundërshtim me ligjet organike dhe të posaçme që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e një institucioni publik, por ndryshimi është që këto vepra penale diferencohen për shkak të natyrës së funksionit dhe objektit të posaçëm që mbrojnë. Në princip të gjitha këto vepra penale janë formë e shpërdorimit të detyrës.


Në shumicën e rasteve diskutimi juridik zhvillohet nëse veprat e sipërcituara konkurrojnë me veprën penale të shpërdorimit të detyrës dhe cilat do jenë rastet kur kjo e fundit do të aplikohet.

Duke u bazuar dhe në jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë, në analizën që i ka bërë veprës penale të parashikuar në nenin 181/a ‘Moskryerja e detyrave nga organet tatimore’ në raport me nenin 248 “Shpërdorim i detyrës”, ka analizuar se neni 181/a është një variant i figurës së përgjithshme të krimit të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i tij, e cila realizohet në një fushe specifike të veprimtarisë shtetërore sikurse është ajo e tatim taksave dhe prandaj këto dy figura krimi nuk mund të konkurrojnë me njëra-tjetrën. [2]Duke marrë si analogji këtë analizë të gjykatës konkludojmë që në varësi të fushës dhe objektit të posaçëm, duhet të kualifikohet dhe

vepra penale dhe mos të procedohet duke i kualifikuar të gjitha veprimet dhe mosveprimet si shpërdorim detyre.

Për të pasur një tablo më të qartë në lidhje me veprat penale dhe marzhin e dënimit për secilën prej tyre, po i paraqesim grafikisht si më poshtë: [3]

Grafiku 1 - Veprat penale dhe marzhi i dënimit



Siç vihet re nga grafiku i mësipërm, kemi disa vepra penale, që në objekt të drejtpërdrejtë apo indirekt kanë mbrojtjen e ekonomisë së shtetit, duke i specifikuar në bazë të natyrës së veprimtarisë shtetërore, si taksat/tatimet, doganat, subvencionet, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore etj.

Në lidhje me marzhin e dënimit konstatohet që është shumë i gjerë që varion nga 5 ditë deri në maksimumin 10 vite, duke i lënë diskrecion shumë të lartë gjykatës për të vendosur, e cila shpesh sjell dhe cenimin e barazisë, sigurisë juridike dhe vlerësimit joproporcional të veprës me faktet, pasi për të njëjtën vepër penale pavarësisht dëmit që ka sjellë në buxhetin e shtetit, personat mund të vihen përpara përgjegjësisë penale me dënime haptazi të ndryshme dhe jo proporcionale. Nga praktika gjyqësore dhe nga analiza e të dhënave, konstatohet që shumë nga veprat penale të sipërcituara nuk aplikohen asnjëherë, duke i kualifikuar si vepra penale të shpërdorimit të detyrës apo vjedhje të pasurisë së shtetit.

Raporti midis dëmit në buxhetin e shtetit dhe ngarkimit me përgjegjësi penale

Funksionarët publikë, të cilët janë të punësuar në administratën publike kanë detyrimin të marrin çdo masë në respektim të ligjit që të mbrojnë buxhetin e shtetit, duke shmangur çdo veprim apo mosveprim që mund të sjell dëm ekonomik. Mirëadministrimi në përputhje me ligjin të buxhetit/fondeve publike ndikon në zhvillimin e një vendi dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët.


Pavarësisht përgjegjësisë që mbart çdo funksionar publik për mbrojtjen e buxhetit të shtetit, Kontrolli i Lartë i Shtetit në çdo raportim vjetor ka dalë në përfundime që buxhetit të shtetit i shkaktohen dëme të konsiderueshme për shkak të kryerjes së veprimeve në kundërshtim me ligjin, moszbatimin e detyrimeve ligjore apo moskryerjen e veprimeve, të cilat janë të detyrueshme për tu kryer nga funksionarët publikë.

Për vitin 2022, KLSH, në përfundim të auditimeve të kryera[4] ka konstatuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në shumën totale prej 107,488,177 mijë lekë, kryesisht në administratën tatimore dhe atë doganore, nga të cilat 105,984,387 mijë lekë në administratën tatimore si detyrime dhe penalitete të vlerësuara në shumat respektive 78,447,741 mijë lekë dhe 27,536,646 mijë lekë, si dhe 1,503,790 mijë lekë efekte negative me ndikim në të ardhurat doganore.[5]

Ndonëse janë marrë një sërë reformash administrative dhe penale për të minimizuar keqmenaxhimin e buxhetit të shtetit, niveli i dëmit ekonomik për shkak të veprimeve dhe mosveprimeve të funksionarëve publikë nuk është ulur.

Referuar analizës së të dhënave të paraqitura nga prokuroria e përgjithshme, numri i procedimit penal në raport me ngarkimin me përgjegjësi penale për veprat penale me objekt mbrojtjen e buxhetit të shtetit, paraqitet grafikisht si më poshtë:

Grafiku 2 - Numri i procedimit penal në raport me ngarkimin me përgjegjësi penale për veprat penale me objekt mbrojtjen e buxhetit të shtetit



Nga raporti vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminalitetit për vitin 2021, ka rezultuar se numrin më të lartë të veprave penale në fushën e mirëfunksionimit të aparatit shtetëror, ku në thelb ka dhe mbrojtjen e ekonomisë së shtetit e zë vepra penale e shpërdorimit të detyrës. Konkretisht në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetëror ose në shërbim publik” 92.57% e zë vepra penale e parashikuar në nenin 248 Kodit Penal “Shpërdorim detyre”, ndërsa për vitin 2021 ky tregues ka qenë 93.09%.[6]

Sipas të dhënave të paraqitura në grafikun e mësipërme dhe raportit konstatohet që vepra e dytë me numrin më të lartë të procedimeve e zë vepra penale e vjedhjes së pasurisë shtetërore. Nëse analizojmë raportin midis numrit të procedimeve të nisura ka një tendencë në rritje prej 14.7 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën”, në krahasim me vitin 2020. Sa i përket veprave penale të korrupsionit në fushën e përgjegjësisë së prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, vërehet tendencë në rritjen për vitin 2021, krahasuar me vitin 2020. Ndërkohë që veprat penale në fushën e taksave dhe tatimeve zën; 1.11 % të veprave penale në shkallë vendi etj.

Pavarësisht se dëmi në buxhetin e shtetit është shumë i lartë, numri i procedimeve të iniciuara dhe personave të ngarkuar me përgjegjësi penale është disproporcional. Personat e ngarkuar me përgjegjësi penale janë në numër shumë të ulët. P.sh. për vitin 2022 janë ngarkuar me përgjegjësi penale vetëm në 17% të çështjeve të regjistruara.

Nga grafiku i mësipërm konstatohet që disa nga veprat penale nuk janë zbatuar asnjëherë ku, konkretisht për dy vitet e fundit nuk kemi asnjë procedim dhe asnjë të dënuar për veprën penale të parashikuar në nenin 181/a; 248/a; 257; 258 të Kodit Penal ndërsa për veprën penale 175, 257 dhe 258 janë shumë pak të zbatuara.

Nga analiza e të dhënave zyrtare në krahasim me veprat penale që kanë për objekt mbrojtjen e interesave ekonomik; të shtetit, konstatohet që arsyeja pse shumë nga veprimet dhe

mosveprimet e funksionarëve publik; kualifikohen si shpërdorim detyre, ka të bëjë me marzhin e dënimit që parashikon kjo vepër penale dhe mundësinë e aplikimit të dënimeve alternative.

Rëndësi nuk paraqet vetëm identifikimi i personave përgjegjës dhe dënimi i tyre, por edhe zhdëmtimi dhe riparimi i dëmit të shkaktuar nga veprimet ose mosveprimet e autorëve të veprave penale. KLSH, në përfundim të auditimeve të kryera përgjatë periudhës janar – dhjetor 2022 ka zbuluar parregullsi dhe shkelje financiare me pasojë dëm ekonomik në të ardhura dhe shpenzime në shumën totale prej 1,508,739 mijë lekë, nga e cila ka rekomanduar për shpërblim dëmi të njëjtën shumë. Por, nga raporti vjetor dëmi i shkaktuar konstatohet që është në vlerën 107,488,177 mijë lekë, shumë herë më i lartë se vlera e shpërblimit të rekomanduar. [7]

Me ndryshimet e fundit një rol i rëndësishëm i është dhënë kompetencë Avokaturës së Shtetit në riparimin e dëmeve që i shkaktohen buxhetit të shtetit. Roli i saj nuk ka të bëjë më vetëm me mbrojtjen e interesit të shtetit në proceset gjyqësore ku një nga palët është institucion shtetëror, por edhe në të drejtën për të ngritur padi regresi ndaj subjekteve që kanë përfituar me të padrejtë nga fondet shtetërore apo buxheti i shtetit duke sjellë dëm ekonomik, e cila përkthehet në uljen e të ardhurave për investime në shërbime publike, arsim, strehim etj.[8]

Gjithashtu Kodi i Procedurës Penale parashikon dispozita për ngritjen e padive civile në procesin penal, si rrjedhojë institucionet që bëjnë kallëzime penale, si KLSH, Drejtoria e Tatimeve etj. mund të paraqesin dhe padi civile në proceset gjyqësore që iniciohen në bazë të kallëzimeve të tyre për të kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar.

Ndonëse janë krijuar një sërë strukturash në nivel administrate dhe në sistemin gjyqësor për hetimin dhe vendosjen përpara përgjegjësisë së personave që i shkaktojnë dëm interesave ekonomik; të shtetit, si dhe janë parashikuar një sërë mjeteve juridike për riparimin e dëmit të shkaktuar, ende kemi një raport të zhdrejtë midis dëmit të shkaktuar dhe riparimit të këtij dëmi nëpërmjet aplikimit të masave administrative apo penale.

Nga analiza e mësipërme konstatohet që mbrojtja e interesave ekonomikë të shtetit dhe mirëadministrimi i aparatit shtetëror është rregulluar nga disa dispozita penale, duke mbuluar në mënyrë të plotë dhe specifike të gjithë veprimtarinë shtetërore. Ndonëse kemi një kuadër ligjor të plotë, zbatimi i tij në praktikë nuk reflekton politikën parandaluese dheriparimin e dëmit që i shkaktohet buxhetit të shtetit.

Në përfundim të analizës së mësipërme, rekomandojmë që:

- Megjithëse kemi disa vepra penale, disa prej tyre gjejnë pak apo aspak zbatim në praktikë, duke ngritur nevojën për rishikimin e këtyre veprave penale duke e orientuar politikën penale drejtë uniformizimit të veprave penale.
 - Lloji i dënimit dhe marzhet e dënimeve të këtyre veprave penale duhet të rishikohen.
 - Ligjzbatuesit duhet të kualifikojnë veprimet apo mosveprimet e një funksionari publik sipas specifikës dhe natyrës së funksionit të tyre duke respektuar në mënyrë të saktë dispozitat e Kodit Penal dhe parimet për një proces të rregullt ligjor.
 - Qëllimi i ngarkimit me përgjegjësi të një punonjësi të administratës publike, duhet të orientohet drejtë parandalimit, minimizimit të dëmeve që mund të shkaktohen në buxhetin e shtetit duke aplikuar dënimet me gjobë dhe dënimet alternative të pezullimit të së drejtës për të punuar në funksione publike.
- Institucionet kompetente duhet të intensifikojnë veprimet dhe të përdorin mjetet ligjore për të zhdëmtuar dëmin që i shkaktohet buxhetit të shtetit

[1] Krahas këtyre shtatë veprave penale janë parashikuar dhe disa vepra të tjera penale që kanë për objekt mbrojtjen e funksionimit të administratës publike edhe nga veprimet apo mosveprimet e qytetarëve, por për efekt të këtij dokumenti do ndalemi të veprat penale me subjekt të posaçëm, pra veprat që kryhen nga funksionarët publikë dhe kanë ndikim negativ në buxhetin e shtetit.

[2] Shih Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë nr.1, datë 12.03.2002

[3] Sqarim vlera 0.05 është vendosur për efekt krahasimi dhe i përket konvertimit me 5 ditë, pasi vepra penale nuk parashikon minimum dhe duke u bazuar në nenin 32 të Kodit Penal dënimi me burg vijon nga 5 ditë. Ndërsa 0.6 është 6 muaj.

[4] Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën janar – dhjetor 2022 ka vijuar punën audituese në zbatim të planit të miratuar me vendimin nr. 215 datë 22.12.2021 të Kryetarit të KLSH-së, duke kryer dhe evaduar 177 misione auditimi, në vlerësim të përputhshmërisë, rregullshmërisë financiare, performancës dhe ndjekjes së statusit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në periudha të mëparshme. Auditimet e kryera kanë përfshirë vlerësimin e aktivitetit në 205 subjekte duke përfshirë të gjitha nivelet e qeverisjes.

[5] Buletini statistikor Janar-Dhjetor 2022, <https://panel.klsh.org.al/storage/php8w5nX4.pdf>

[6] Raporti Vjetor për vitin 2022, Prokuroria e Përgjithshme, aksesuar në linkun: https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE_T_PR_OKURORIT_T_P_RGJITHSH_M/

[7] Buletini statistikor Janar-Dhjetor 2022, <https://panel.klsh.org.al/storage/php8w5nX4.pdf>

[8] Ligji nr. 10 O18, dt. 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, neni 5, pika e “ka të drejtë të ngrejë padi, me objekt shpërblimin e dëmit të shkaktuar interesave pasurorë të shtetit, me autorizimin e organit shtetëror përkatës, me përjashtim të rasteve të urgjencës”

“Buxhet” - është tërësia e të ardhurave, shpenzimeve dhe financimeve të qeverisjes qendrore e vendore dhe të fondeve speciale, të cilat miratohen me ligj nga Kuvendi i Shqipërisë, më poshtë “Kuvendi” ose me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore.

“E ardhur” - është rritja e pasurisë neto, e cila përfundon me arkëtime kapitale ose korrente, me ose pa detyrim kthimi.

“Shpenzim” - është pakësimi i pasurisë neto, e cila përfundon me kryerjen e pagesave kapitale ose korrente, të pakthyeshme, me ose pa detyrim kthimi.

“Fond special” - është fondi i krijuar me ligj, i cili ka si burime të ardhurat tatimore ose jotatimore, që përdoren vetëm për financimin e funksioneve apo të veprimtarive të veçanta të qeverisjes qendrore apo vendore.

“Grant” është e ardhura, e përftuar në formën e dhurimit, për një qëllim të përcaktuar ose jo, pa kusht kthimi dhe pa interes, që përdoret për financimin e veprimtarive ekonomike.

“Borxh” është shuma e huave të marra në tregun bankar, financiar dhe nga palë të treta, persona fizikë, juridikë ose individë, me kusht kthimi, me ose pa interes, për financimin e projekteve të caktuara të investimeve, mungesës së përkohshme të likuiditeteve dhe të deficitit fiskal buxhetor.

“Menaxhim financiar” është tërësia e përgjegjësisë të menaxhimit, që ushtrojnë njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për miratimin dhe zbatimin e rregullave dhe të

procedurave, që sigurojnë përdorim eficient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike, në dispozicion.

“Vepër penale me objekt mbrojtjen e fondeve/buxhetit të shtetit” është ndërmarrja në kundërshtim me ligjin të veprimeve dhe mosveprimeve nga punonjësit dhe nëpunësit e administratës publike që cenojnë mirëmenaxhimin e parave publike dhe i shkaktojnë dëm buxhetit të shtetit, të cilat janë ngritur në nivelin e veprave penale nga Kodi Penal apo ligje të tjera të posaçme.

Neni 135 K.P - Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën: “Vjedhja e pasurisë e kryer nga personi, që ka për detyrë ta ruajë dhe ta administrojë atë, apo duke shpërdoruar detyrën, dënohet me burgim gjer në dhjetë vjet”.

Neni 175 K.P - Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore: “Kryerja e kontrabandës nga punonjës të doganave ose punonjës që kanë lidhje me veprimtarinë doganore, qoftë edhe në bashkëpunim me persona të tjerë, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet”.

Neni 181/a – Moskryerja e detyrave nga organet tatimore: “Moskryerja e detyrave që lidhen me vjeljen brenda afatit të caktuar ligjor të taksave dhe tatimeve nga punonjësit e organeve tatimore dhe personat e tjerë zyrtarë, që janë ngarkuar me këto detyra, kur bëhet për fajin e tyre, dënohet me burgim deri në shtatë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet”.

Neni 248 K.P - Shpërdorimi i detyrës: “Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”.

Neni 248/a K.P - Dhënia në kundërshtim me ligjin e pensioneve ose e të ardhurave të tjera nga sigurimet shoqërore: “Dhënia në kundërshtim me ligjin e pensioneve ose e të ardhurave të tjera nga sigurimet shoqërore prej punonjësit, që ka detyrë t’i japë ato, dënohet me burgim, nga gjashtë muaj gjer në shtatë vjet”

Neni 258 - Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike: “Kryerja nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik i veprimeve në kundërshtim me ligjet që rregullojnë lirinë e pjesëmarrjes dhe barazinë e shtetasve në tendera dhe ankande publike, për të krijuar avantazhe ose privilegje të padrejta për të tretët, kur tenderi ose ankandi publik është deri në vlerën 800.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim deri në një vit.

Po kjo vepër, kur kryhet në tender ose ankande publike me vlerë mbi 800.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet”.

Neni 259 - Korrupsioni pasiv i personave që ushtrajnë funksione publike: - Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë deri në vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në tre vjet. Po kjo vepër, kur përfitimi i parregullt ose premtimi i një përfitimi të tillë është mbi vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet